

BULETIN JAVOR

12-16 SHKURT 2024



Shprehja

"Kur bëhet fjalë për privatësinë dhe përgjegjshmërinë, njerëzit gjithmonë kërkojnë të parën për veten e tyre dhe të dytën për të gjithë të tjerët."

David Brin

e javës

Përmbajtja:

- AKCESK organizon trajnimin dy ditor për Higjienën Kibernetike
- AKCESK në një takim me përfaqësues të qeverisë amerikane.
- Banka e Amerikës -data breach
- Roundcube- patching alert



AKCESK organizon trajnimin dy ditor për Higjienën Kibernetike

Mos-përditësimi i sistemit të operimit, mashtrimet phishing apo SMishing janë një sërë rreziqesh në botën e sotme digjitale që mund të kompromentojnë sigurinë tuaj online!

Kjo është arsyeja pse AKCESK, në bashkëpunim me CRDF, me mbështetjen e Departamentit Amerikan të Shtetit, organizoi trajnimin dy ditor mbi Higjienën Kibernetike në datat 12 & 13 Shkurt.

Ky trajnim u ndoq nga 420 pjesëmarrës online si dhe 50 pjesëmarrës në sallë duke përfshirë punonjës të profileve të ndryshme nga të gjitha institucionet publike, sektori privat si dhe shoqëria civile. Gjatë trajnimit u trajtuan çështje të tilla si mbajtja e sistemit operativ të përditësuar, përdorimi i fjalëkalimeve të sigurta dhe unike, aktivizimi i autentifikimit me dy faktorë si dhe kujdesi që duhet treguar ndaj linqeve apo shkarkimeve të dyshimta.

AKCESK vlerëson përfshirjen e të gjithë kategorive të shoqërisë në trajnime të tilla me qëllim ndërgjegjësimin dhe rritjen e vigjilencës nga kërcënimet e vazhdueshme kibernetike.



AKCESK në një takim me përfaqësues të qeverisë amerikane.

Në kuadër të partneritetit strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe angazhimit për forcimin e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar, AKCESK zhvilloi sot një takim me përfaqësues të qeverisë amerikane. Në fokus të takimit ishin mundësitë e bashkëpunimit për rritjen e kapaciteteve të sigurisë kibernetike dhe diskutimet treguan një perspektivë të qartë të bashkëpunimit në këtë drejtim.



Banka e Amerikës - data breach

Banka e Amerikës ka raportuar një shkelje të të dhënave që përfshin Infosys McCamish Systems (IMS), një ofrues shërbimi që u hakerua vitin e kaluar.

Shkelja ekspozoi informacione personale duke përfshirë emrat, adresat, numrat e sigurimeve shoqërore dhe detajet financiare. Shkelja preku 57,028 persona, me IMS që njoftoi Bankën e Amerikës se të dhënat në lidhje me planet e kompensimit të shtyrë mund të jenë komprometuar. Banka ende nuk ka bërë të ditur numrin e klientëve të prekur.

[Link: Lexo më shumë](#)

PATCHING ALERT



Roundcube - patching alert

Agjencia Amerikane e Sigurisë Kibernetike dhe Sigurisë së Infrastrukturës (CISA) ka shtuar një vulnerabilitet me ashpërsi mesatare në software-in e emailit Roundcube në katalogun e saj të vulnerabiliteteve të njohura për shkak të shfrytëzimit aktiv.

I identifikuar si: CVE-2023-43770, ky vulnerabilitet prek versionet para 1.4.14, 1.5.x përpara 1.5.4 dhe 1.6.x para 1.6.3. Agjencive të Degës Ekzekutive Civile Federale të SHBA-së u kërkohet të aplikojnë përditësimet e ofruara deri më 4 mars 2024.

[Link: Lexo më shumë](#)